



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja c), nenit 58, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), si dhe nenit 26 pika 7, nenit 56 pika 2, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Me kërkesën e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.02.2024, miraton këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01.NR. XI-8/1, DT.30.11.2020 PËR PAGESËN E SHUJTËS PËR TË GJITHË TË PUNËSUARIT NË ADMINISTRATËN E KOMUNËS SË DEÇANIT

I.

Me këtë Vendim bëhet SHFUQIZIMI i Vendimit të Kuvendit 01.Nr. XI-8/1, dt.30.11.2020 për pagesën e shujtës për të gjithë të punësuarit në administratën e Komunës së Deçanit.

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.


IV.

Me Vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoritë Komunale dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-3

Deçan, dt.29.02.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ





Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronjat (c dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 21 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.02.2024, bie këtë:

V E N D I M

MBI THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR HARMONIZIMIN E NDRYSHIMEVE DHE PLOTËSIMEVE TË RREGULLORES PËR SHËRBIME PUBLIKE

I.

Themelohet Komisioni për përpunimin dhe harmonizimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të rregullores për shërbime publike , në këtë përbërje:

1.Shaban Haxhaj (Drejtorja SHP), 2.Ali Mataj(drejtorja SHP), 3. Ajne Iberhysaj (Drejtorja Inspektionit), 4.Arjan Dobraj (Asamble AAK), 5.Teuta Neziraj(Asamble VV), 6.Mon Selmonaj (Asamble PDK), 7.Shkelqim Tolaj (Asamble LDK).

Mbledhjen e parë të Komisionit e thirre Kryesuesi i Kuvendit, në atë mbledhje komisioni e zgjedhë Kryesuesin nga radhët e veta.

II.

Detyrë e Komisionit është që të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Shërbime Publike, dhe t'a harmonizon ate me Statutin e Komunës dhe të gjitha ligjet në fuqi. Pas përgatitjes së materialit, Komisioni i dorëzon materialin për shqyrtim dhe miratim KPF-së dhe Kuvendit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.


Me nga një kopje të Vendimit paisen, të emruarit në pikën I. dhe Arhivi.

01.Nr.II-V/2

Deçan,dt.29.02.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUPAJ





Në bazë të kërkesës së Kryetarit të Komunës, të dt.21.02.2024, nr.02-5981, ndarjen e 5,000.00 € për pagesën e transportit të donacionit për pajisjet e shkollave dhe QKMF, nga Suedia në Deçan, në mbështetje të nenit 52.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, dhe nenit 51 paragrafi 51.2 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.26.02.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E 5.000 EURO PËR PAGESËN E TRANSPORTIT TË DONACIONIT PËR PAJISJET E SHKOLLAVE DHE QKMF, NGA SUEEDIA NË DEÇAN

I.

Merret Vendimi për ndarjen e 5,000 € për pagesën e transportit të donacionit për pajisjet e shkollave dhe QKMF, nga Suedia në Deçan, që kryesisht përbëhet nga materiali shkollor dhe materiali për qëllime mjekësore të dedikuar për QKMF, i cili është donacion nga z.Xhafer Balaj, bashkatdhetar i yni në Suedi.

Mjetet financiare do të derdhen në llogarinë rrjedhëse të Shoqata KIF “Liria” me nr. Biznesi 802439-8375, llogaria rrjedhëse nr.1506021630869 në Raiffeisen Bank Kosova.

II.

Mjetet financiare të miratuara si në pikën I. Të këtij Vendimi ndahen nga Linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit, ose Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, në kategorinë e Subvencioneve.

III.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa.


V.

Me Vendim njoftohen: Shoqata KIF “Liria” e përfaq e përfaqësuar nga Xhafer Balaj, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-3

Deçan,dt.26.02.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në harmoni me Ligjin Nr.04/L-071 për Sistemin e Adresave, si dhe në bazë të nenit 26 pika 6 dhe pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit , në mbledhjen e mbajtur me dt.29.02.2024, bie këtë:

V E N D I M

MBI PLOTËSIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR EMËRTIMIN DHE RIEMËRTIMIN E SHESHEVE, RRUGËVE DHE LAGJEVE URBANE

I.

Me këtë Vendim bëhet Ndryshimi i Vendimit të Kuvendit të dt.31.05.2023, 01.Nr.V-8/1, dhe bëhet PLOTËSIMI i Komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e Shesheve, Rrugëve dhe Lagjeve Urbane, në teritorin e Komunës së Deçanit.

Plotësimi i Komisionit bëhet me znj.Vjollca Tetaj.

II.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.


Me Vendim paiset e përmendura në pikën I. Të Vendimit, Kryetari i Komunës dhe Arhivi.

01.Nr.II-V/3

Deçan,dt.31.05.2023

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ





Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronjat (c dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 26 pika 3, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, në përputhje me Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.02.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT PËR TRASHËGIMINË KULTURORE TË KOMUNËS SË DEÇANIT 2024-2029

Neni 1

Aprovohet Plani për Trashëgiminë Kulturore të Komunës së Deçanit 2024-2029.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Plani për Trashëgiminë Kulturore të Komunës së Deçanit 2024-2029.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte e Komunës së Deçanit.

Neni 4


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: MAPL-së, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte dhe Arhivit.

01.Nr.II-4

Deçan, dt.29.02.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:
Hajdar SUTAJ





Ne bazë të nenit 14 dhe nenit 58 pika a), b), d), g) i), të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, në bazë të nenit 3 paragrafi 1.4, 1.12 dhe 1.13, nenit 5, 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 dhe paragrafi 1 nen paragrafi 1.2, nenit 14, nenit 19 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.10/03, Prill 2019), në bazë të nenit 13 dhe nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 22 dhe 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, me propozimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.02.2024, merr këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM
AFATGJATË

- I. MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite.
- II. Prona e paluajtshme e komunës së Deçanit që jepet në shfrytëzim afatgjatë është në harmoni me dokumentet e planifikimit hapësinorë të Komunës: Parcela kadastrale e identifikuar me certifikatë të pronësisë Nr.00429-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 23036 m², me kulturë Mal i klasës 4, Zona kadastrale Deçan, në pronësi të Komunës së Deçanit.
- III. Prona e paluajtshme e Komunës jepet në shfrytëzim afatgjatë z.Mehmet Osaj.
- IV. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Deçanit është për ndërtimin e projektit Kompleksin Rekreativë-Turistik “PODI I GËSHTENJAVE” në Deçan, që do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të Komunës.
- V. Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, është si në pikën I. të këtij vendimi, për 99 vite.
- VI. Prona e paluajtshme e cekur në pikën II. Të Vendimit jepet në shfrytëzim me kompensim.
- VII. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.
- VIII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim e përshkruar në pikën II të këtij vendimi duhet të evidentohet në librat kadastrale të Komunës.
- IX. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtoritë kompetente të Komunës së Deçanit.
- X. Vendimi hyn në fuqi 15 (pasëmbëdhjet) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.II-V/2

Deçan, dt.29.02.2024

DEÇAN - DEÇANI - DEÇAN	
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT MUNICIPALITY OF DEÇAN OPSTINA DEÇAN	
Nr. i regjistruar No. regjistruar	7648
Nr. i datës No. datës	01 07-03-24



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

[Handwritten signature]



Me kërkesën e Drejtorisë për BPZHR, të dt.16.02.2024, nr.01/5620, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 20,000.00 € për bashkëfinancim me Organizatat Jo Qeveritare në projekte nga lëmia e bujqësisë, në bazë të nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), si dhe nenit 26 pika 2 dhe 3 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.02.2024, merr këtë:


V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR BASHKËFINANCIM ME O.J.Q.-TË NË PROJEKTET E PËRBASHKËTA NGA LËMIA E BUJQËSISË

- I. Aprovohen mjetet financiare për bashkëfinancim me Organizatat Jo Qeveritare në projekte nga lëmia e bujqësisë, për fermerët e Komunës së Deçanit, në shumën 20,000.00€ (njëzetmijëeuro).
- II. Mjetet financiare, si në pikën I. të këtij vendimi ndahen nga linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit ose Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nga kategoria e subvencioneve.
- III. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa e KK Deçan.
- IV. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.
- V. Me vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për BPZHR dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-2

Deçan, dt.29.02.2024



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ